



EDUKIMI DHE FORMIMI I MËSUESVE PËR GJITHËPËRFSHIRJEN

Profili i mësuesit gjithëpërfshirës

Tiranë 2015

Ky botim është rezultat i një grupi pune të ngritur në kuadrin e projektit “Adresimi i sfidave të Arsimit Gjithpërfshirës në Shqipëri” të vënë në zbatim nga Instituti për Studime të Opinioneve Publik mbështetur nga Zyra e Unicef në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si dhe Institutin e Zhvillimit të Arsimit të cilët mundësuan përshtatjen dhe realizimin e këtij botimi. Profili i mësuesit gjithëpërfshirës është bazuar në manualin me po të njëjtin emër realizuar nga “Agjencia Europiane për Zhvillim në Arsimin Special”.

Grupi i punës:

Albana Markja

Dr. Marina Ndrio

Prof. Dr. Edmond Dragoti

Prof. Asoc. Irida Agolli



Contents

Sfondi i përgjithshëm	4
Përdorimi i profilit të mësuesit gjithëpërfshirës.....	5
Profili i mësuesit gjithëpërfshirës	6
Zbatimi i profilit të mësuesit gjithëpërfshirës	19
Parime të përgjithshme.....	19
Zbatimi i profilit.....	20
Procesi i hartimit të profilit.....	20
Referencat.....	22

Sfondi i përgjithshëm

“Edukimi dhe formimi i mësuesve për gjithëpërfshirjen - Profili i mësuesit gjithëpërfshirës” ka si qëllim evidentimin e aftësive thelbësore, dijeve, qëndrimeve dhe vlerave që duhet të ketë gjithësecili mësues, si ai që përgatitet t’i bashkohet rradhëve të profesionit të mësuesisë ashtu dhe ai që është në shërbim, pavarësisht nga lënda që jep, specializimi apo grupmosha ku jep mësim.

Profili i Mësuesit Gjithëpërfshirës konsiderohet një dokument në nivel politikash arsimore. Ai është pjesë e paketës së dokumenteve që synojnë përmirësimin e ndërtimit dhe funksionit të institucioneve arsimore duke çuar në ndryshime cilësore në edukim. Nga ana tjetër, veçmas, ai kontribuon dhe shërben si bazë standardesh e kompetencash për përmirësimin e zhvillimit profesional, fillestar dhe të vazhdueshëm të mësuesve, në drejtim të të qenit një profesionist gjithëpërfshirës.

Hartimi i këtij dokumenti është iniciativë e MAS-it, IZHA-s dhe Unicef, në bashkëpunim me Institutin e Studimeve të Opinioneve Publik. Nga ekspertët dhe hartuesit e dokumentit, mësuesi gjithëpërfshirës vlerësohet si *një agjent* i rëndësishëm që garanton cilësinë e edukimit Gjithashtu, mësuesi gjithëpërfshirës konsiderohet si një komponent i domosdoshëm në përmbushjen e gamës së kërkesave për realizimin efektiv të reformave në arsim, si dhe në proceset e zhvillimit profesional gjatë përgatitjes fillestare dhe punës së tij.

Në përpjekjet për hartimin e Profilit të Mësuesit Gjithëpërfshirës janë pasur parasysh disa momente dhe procese të rëndësishme, si:

- përvoja e gjatë e krijuar nga institucione publike dhe jopublike, agjenci dhe organizata të ndryshme, në hartimin e materialeve burimore mbështetëse dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të mësuesve në fushën e arsimit gjithëpërfshirës;
- përvoja e krijuar për hartimin e standardeve në fusha të tjera të zhvillimeve arsimore, veçanërisht të atyre të mësuesit në arsimin parauniversitar;
- prioriteti që i është dhënë aktualisht arsimit gjithëpërfshirës në sistemin tonë arsimor, e reflektuar kjo përmes dokumenteve kryesorë strategjikë, ligjeve dhe akteve nënligjore në fushën e arsimit;
- mungesat e vërejtura në drejtim të standardizimit të kompetencave kryesore të mësuesit gjithëpërfshirës në sistemin tonë arsimor; si dhe
- konsolidimi i mendimit se nëpërmjet standardeve sigurohet rruga më e mirë për përmirësimin e fushave të ndryshme, që lidhen me arsimin gjithëpërfshirës.

Përdorimi i profilit të mësuesit gjithëpërfshirës

Përdoruesi i parë dhe më kryesor i Profilit të Mësuesit Gjithëpërfshirës është mësuesi, të cilin kompetencat e përcaktuara e ndihmojnë për t'u orientuar më mirë në përgatitjen, zhvillimin dhe karrierën e tij profesionale, për përmirësimin e cilësisë së punës si mësues, për të zotëruar aftësitë dhe vlerat e domosdoshme si profesionist, për të ndryshuar sjellje dhe qëndrime të caktuara ose për të bërë plotësimet e nevojshme.

Përdoruesit e tjerë të këtij dokumenti janë:

- Politikëbërësit, të cilët kanë në dorë të ndikojnë tek politikat për formimin dhe zhvillimin profesional të mësuesve, për garantimin e përfshirjes së tyre dhe më pas nisjen dhe zbatimin e ndryshimeve në praktikë.
- Institucionet e arsimit të lartë që përgatisin punonjës arsimorë, të cilët mund t'i përdorin kompetencat e mësuesit gjithëpërfshirës për të hartuar dhe ndërtuar programet e tyre të formimit profesional.
- Institucionet publike ose jopublike që hartojnë dhe ofrojnë programe e module për zhvillimin profesional të mësuesve, përgatisin dhe botojnë materiale në ndihmë të mësuesit, ofrojnë dhe zhvillojnë trajnime për mësuesit etj.

Profili i Mësuesit Gjithëpërfshirës është përpiluar kryesisht si një udhëzues për hartimin dhe zbatimin e programeve për zhvillimin profesional të mësuesve. Në mënyrë specifike, objektivat e këtij dokumenti janë:

1. Formësimi i një kornize vlerash bazë dhe kompetencash të cilat mund të jenë të aplikueshme për çdo program të formimit të mësuesve;
2. Evidentimi i vlerave themelore bazë dhe kompetencave që nevojiten për përgatitjen e të gjithë mësuesve në mënyrë që ata të jenë të aftë të punojnë në arsimin gjithëpërfshirës, duke marrë në konsideratë të gjitha format e diversitetit;
3. Identifikimi i faktorëve kryesorë që mbështesin zbatimin e vlerave bazë të propozuara dhe kompetencave për arsimin gjithëpërfshirës brenda kontekstit të të gjitha programeve të formimit dhe zhvillimit profesional të mësuesve;
4. Përforcimi i argumentit sipas të cilit arsimit gjithëpërfshirës është përgjegjësi e të gjithë mësuesve, ndaj edhe përgatitja e të gjithë punonjësve arsimorë për të punuar në institucione dhe mjedise gjithëpërfshirëse mbetet përgjegjësi e të gjithë atyre që përgatisin mësuesit e ardhshëm dhe atyre që punojnë në institucionet arsimore.

Profili i mësuesit gjithëpërfshirës

Puna për hartimin e Profilit u bazua mbi disa parime dhe parakushte:

1. Gjithëpërfshirja është një qasje parimore, e bazuar tek e drejta për arsim në themel të së cilës qëndrojnë një sërë vlerash themelore;
2. Ekzistojnë vështirësi praktike dhe konceptuale për sa i takon përqëndrimin në kompetenca të fokusuar te mësimdhënia në arsimin gjithëpërfshirës dhe që Profili t'u përshtatej aktorëve të ndryshëm të interesit kërkohej një qasje më e gjerë sa i takon idesë së përdorimit të kompetencave;
3. Përparësitë politike dhe efektet e politikave arsimore në vend, nuk mund të mos merren në konsideratë, por ka edhe një kuadër politikash në rang ndërkombëtar dhe në BE, të cilat kanë të bëjnë **me arsimin** gjithëpërfshirës dhe formimin e mësuesve që kërkohet të merren parasysh.

Janë evidentuar disa vlera themelore që lidhen me mësimdhënien dhe të nxënin dhe që shërbejnë si baza për punën e të gjithë mësuesve në arsimin gjithëpërfshirës.

1. **Vlerësimi i diversitetit të nxënësit** – dallimet mes nxënësve konsiderohen si një burim dhe vlerë për edukimin dhe jo si pengesë;
2. **Mbështetja e të gjithë nxënësve** – mësuesit kanë pritshmëri të larta për arritjet shkollore apo dhe në fusha të tjera të çdo nxënësi;
3. **Bashkëpunimi me të tjerët** – bashkëpunimi dhe puna në ekip janë elementë thelbësorë në punën e të gjithë mësuesve;
4. **Vazhdimësia e zhvillimit profesional individual** – mësimdhënia është një veprimtari që ka të bëjë me të nxënin dhe mësuesit marrin përgjegjësi për të mësuarin e tyre gjatë gjithë jetës.
5. **Domosdoshmëria e përshtatjes së mësimdhënies në varësi të nevojave dhe aftësive që kanë nxënësit me nevoja të veçanta.**
6. Analizimi i historisë së arsimit gjithëpërfshirës për të kuptuar rrethana dhe kontekste aktuale;

7. Planifikimi i strategjive që i përgatisin mësuesit për të sfiduar qëndrimet mospërfshirëse dhe për të shmangur situatat e përjashtimit;

Këto vlera themelore lidhen me kompetencat e mësuesve gjithëpërfshirës. Kompetencat përbëhen nga tri elementë: qëndrimet, njohuritë dhe aftësitë profesionale. Një qëndrim apo besim i caktuar kërkon një nivel njohurish dhe dije të caktuar, mënyra të reja vlerësimi apo kuptimi dhe më pas edhe aftësi profesionale për t'i zbatuar këto dije në praktikë. Për çdo kompetencë, parashtrohen edhe qëndrimet, njohuritë dhe aftësitë profesionale përkatëse që qëndrojnë në themel të tyre.

Vlen të theksohet që, kompetencat nuk parashtrohen sipas ndonjë rendi hierarkie dhe nuk duhen marrë në konsideratë veçmas, duke qenë se ato janë të gjitha të ndërlidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe po kaq të ndërvlarura nga njëra tjetra.

Kompetencat që paraqiten në këtë dokument janë ato më të rëndësishmet të identifikuara përmes hulumtimeve dhe diskutimeve në kuadrin e përgatitjes së dokumentit. Ato nuk janë shteruese. Ato duhen parë si themele për rrugët e zhvillimit profesional të mësuesve dhe si pika nisjeje për diskutime në nivele të ndryshme mbi kompetencat që duhet të kenë të gjithë mësuesit që punojnë në mjedise të ndryshme, në institucione arsimore të ndryshme.

- 1. Vlerësimi i diversitetit mes nxënësve** – dallimet mes nxënësve konsiderohen si një burim dhe vlerë për edukimin dhe jo si pengesë.

Kompetencat e nevojshme për këtë vlerë themelore janë:

- 1.1 Zotërimi i njohurive mbi arsimin gjithëpërfshirës ;
- 1.2 Ndryshimi i qëndrimeve dhe sjelljeve në lidhje me dallimet mes nxënësve.

1.1 Zotërimi i njohurive mbi arsimin gjithëpërfshirës

Qëndrimet dhe bindjet që lidhen me këtë kompetencë përfshijnë:

- Arsimimi bazohet mbi besimin te barazia, të drejtat e njeriut dhe demokracia për të gjithë nxënësit;
- Arsimi gjithëpërfshirës ka të bëjë me reformën shoqërore dhe është i panegociueshëm;
- Arsimi gjithëpërfshirës dhe cilësia në arsim nuk mund të shihen si dy çështje të ndara;
- Aksesit vetëm në arsimin e zakonshëm nuk është i mjaftueshëm, por duhet që të gjithë nxënësit të jenë pjesëmarrës, domethënë të përfshihen në veprimtari të të nxënësve që janë të përshtatshme për mundësitë e tyre

Njohuritë themelore që lidhen me këtë kompetencë përfshijnë:

- Konceptet teorike dhe praktike që qëndrojnë në themel të arsimit gjithëpërfshirës, si në kontekstin global, ashtu dhe në atë lokal;
- Sistemin e kulturave, politikave dhe praktikave të institucioneve arsimore në të gjithë nivelet që ndikojnë në arsimin gjithëpërfshirës. Identifikimin e pengesave në mësimnxënie dhe alternativat për të planifikuar eliminimin e tyre. Arsimi gjithëpërfshirës si një qasje për të gjithë nxënësit, dhe jo vetëm për ata që perceptohen të kenë nevojë të veçanta arsimore dhe që mund të rrezikohen prej përjashtimit nga mundësitë për t'u arsimuar;
- Gjuha gjithëpërfshirëse, elementët e rinj gjuhësorë si pjesë e proceseve gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të shmangen etiketimet dhe klasifikimet e nxënësve që kanë ritme të ndryshëm zhvillimi
- Arsimi gjithëpërfshirës, si prani (aksesi në arsim), pjesëmarrje (cilësia e përvojës së të nxënësve) dhe arritje (procesi dhe rezultatet e të nxënësve) për të gjithë nxënësit.

Aftësitë themelore që kërkohet të zhvillohen në këtë kompetencë përfshijnë:

- Analizë kritike të pikëpamjeve e qëndrimeve personale dhe të ndikimit që ato kanë tek sjellja dhe veprimet;
- Respektim në mënyrë të vazhdueshme të çështjeve të etikës dhe konfidencialitetit;
- Të qenit empatik ndaj nevojave të ndryshme të nxënësve;
- Modelimi i respektit në marrëdhëniet shoqërore dhe përdorimi i gjuhës së përshtatshme me të gjithë nxënësit dhe aktorët e interesit në arsim.

1.2 Ndryshimi i qëndrimeve dhe sjelljeve në lidhje me dallimet mes nxënësve

Qëndrimet dhe bindjet që lidhen me këtë kompetencë përfshijnë:

- Është normale “të jesh i ndryshëm”. Fëmijët kanë ritme të ndryshme zhvillimi. Çdo fëmijë është unik;
- Duhet të ndryshojë i kuptuari i parimeve të gjithëpërfshirjes. Shkollat dhe i gjithë sistemi arsimor duhet të ndryshojnë për t’ju përshtatur larmisë së nevojave, dhe karakteristikave individuale të nxënësve;
- Gjithëpërfshirja shihet dhe vlerësohet si një proces që sjell përfitime edhe për nxënësit e tjerë, duke bërë që ata të jenë pranues, jodiskriminues dhe mbështetës ndaj bashkëmoshatarëve të tyre;
- Vlerësohet dhe konsiderohet fakti se gjithëpërfshirja në arsim është një aspekt i gjithëpërfshirjes në shoqëri;
- Dallimet ndërmjet nxënësve duhen respektuar, vlerësuar dhe kuptuar, si mënyra që nxisin dhe përmirësojnë mundësitë për të mësuar dhe ju shtojnë vlerën shkollave, komuniteteve lokale dhe shoqërisë;
- Zëri i të gjithë nxënësve duhet dëgjuar dhe vlerësuar;
- Mësuesi luan rol kyç për vetëvlerësimin e nxënësit dhe për rrjedhojë të potencialit të tij të nxënësit;
- Kategorizimi dhe etiketimi i nxënësve mund të ketë efekt negativ në mundësitë e të nxënësit.

Njohuritë themelore që lidhen me këtë kompetencë përfshijnë:

- Nxënësit mund të përdoren si burim për të lehtësuar të nxënin në lidhje me diversitetin, si për vete ashtu edhe për bashkëmoshatarët e tyre;
- Nxënësit mësojnë në mënyra të ndryshme të cilat mund të përdoren për të mbështetur të nxënin e tyre individual dhe atë të moshatarëve të tyre;
- Informacion në lidhje me diversitetin e nxënësve (që lind nga nevoja për mbështetje, dallimet kulturore, gjuhësore, sfondi ekonomiko-shoqëror etj.);
- Shkolla është një mjedis komunitar dhe social që ndikon si në vetëvlerësimin e nxënësve, ashtu edhe në potencialin e tyre të të nxënësit;

- Popullimi i shkollës dhe klasave është në ndryshim të vazhdueshëm; diversiteti nuk mund të perceptohet si një koncept statik.

Aftësitë themelore që kërkohet të zhvillohen në këtë kompetence përfshijnë:

- Aftësimi se si të mësojmë nga dallimet;
- Evidentimi i mënyrave më të përshtatshme për t'iu përgjigjur diversitetit në të gjitha rrethanat;
- Adresimi i diversitetit në zbatimin e kurrikulave;
- Përdorimi i diversitetit në qasjet dhe stilet e të nxënësve si burim për mësimdhënien;
- Kontributi në ndërtimin e shkollave si komunitete të dijes që respektojnë, inkurajojnë dhe vlerësojnë aftësitë e të gjithë nxënësve.
- Shfrytëzimi i burimeve të komunitetit;

2. Mbështetje për të gjithë nxënësit – mësuesit kanë pritshmëri të larta për aftësitë e të gjithë nxënësve.

Kompetencat e nevojshme për këtë vlerë themelore janë:

- 2.1 Nxitja e të nxënësve akademik, praktik, social dhe emocional për të gjithë nxënësit;
- 2.2 Metodologji efikase të mësimdhënies në klasat diverse .

2.1 Nxitja e të nxënësve akademik, praktik, social dhe emocional për të gjithë nxënësit

Qëndrimet dhe bindjet që lidhen me këtë kompetence përfshijnë:

- Procesi i të nxënësve është kryesisht një aktivitet shoqëror;

- Aspektet akademike, praktike, shoqërore dhe emocionale të të nxënit kanë rëndësi të barabartë për të gjithë nxënësit;
- Pritshmëritë që kanë mësuesit janë një faktor përcaktues për suksesin e nxënësve, ndaj edhe pritshmëritë e bazuara në mundësitë reale të çdo nxënësi janë me rëndësi kritike;
- Të gjithë nxënësit duhet të marrin pjesë në vendimmarrje në procesin e të nxënit dhe në çdo proces tjetër vlerësimi ku ata janë të përfshirë;
- Prindërit dhe familjet janë një burim i rëndësishëm për të nxënit e nxënësve;
- Nxitja e autonomisë dhe vetëvendosjes tek të gjithë nxënësit ka rëndësi të posaçme;
- Duhet zbuluar dhe më pas stimuluar kapaciteti dhe potenciali i çdo nxënësi.

Njohuritë themelore që lidhen me këtë kompetence përfshijnë:

- Kuptimin e vlerës së bashkëpunimit me prindërit dhe familjet;
- Kuptimin se prindërit janë një burim i çmuar informacioni në lidhje me fëmijët e tyre;
- Njohjen e modeleve tipike dhe atipike të zhvillimit të fëmijës, në veçanti në lidhje me zhvillimin e aftësive konjitive/njohëse, motorike, sociale, si dhe ato të gjuhës dhe komunikimit;
- Modelet e ndryshme të të nxënit dhe qëndrimeve ndaj të nxënit.

Aftësitë themelore që kërkohet të zhvillohen në këtë kompetence përfshijnë:

- Të qenit një komunikues efikas verbal dhe jo-verbal, për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme të komunikimit të nxënësve, prindërve dhe profesionistëve të tjerë;
- Mbështetja e zhvillimit të aftësive dhe mundësive komunikuese të nxënësve;
- Vlerësimi dhe më pas zhvillimi i “aftësive për të nxënit” tek nxënësit;
- Mbështetja e nxënësve për të qenë të pavarur dhe autonomë;
- Mbështetja e të nxënit bashkëpunues dhe aktiv
- Zbatimi i metodave të menaxhimit pozitiv të sjelljes që nxisin zhvillimin social dhe ndërveprimin;

- Krijimi i rrethanave të të nxëniet ku nxënësit mund të “guxojnë” dhe madje edhe dështojnë në një mjedis të sigurtë;
- Përdorimi i stimulimit për stilet e të nxëniet që marrin në konsideratë të mësuarin në aspektin shoqëror, emocional dhe shkollor.

Metodologji efikase të mësimdhënies në klasat diverse

Qëndrimet dhe bindjet që lidhen me këtë kompetence përfshijnë:

- Mësues të suksesshëm janë ata që dinë të mësojnë të gjithë nxënësit;
- Mësuesit marrin përgjegjësi për të bërë të mundur të nxëniet e të gjithë nxënësve në klasë;
- Mësuesit gjejnë mënyra alternative të pjesëmarrjes së të gjithë nxënësve në jetën shkollore;
- Aftësitë e nxënësve nuk janë të pandryshueshme, të gjithë kanë mundësi për të nxënë dhe për t’u zhvilluar;
- Fëmijët kanë kapacitete dhe potenciale, të cilat duhen nxitur dhe inkurajuar;
- Të nxëniet është një proces dhe synim për të gjithë nxënësit – është zhvillimi i të nxëniet për të fituar aftësi dhe jo vetëm njohuri të lëndëve;
- Në disa raste, sfida të veçanta që kanë të bëjnë me procesin e të nxëniet, kërkojnë reagime të bazuara mbi përshtatje të kurikulës dhe metodave të mësimdhënies.

Njohuritë themelore që lidhen me këtë kompetence përfshijnë:

- Njohuritë teorike mbi mënyrat se si nxënësit mësojnë/nxënë dhe modelet e mësimdhënies që mbështesin procesin e të nxëniet;
- Qasjet mbi sjelljet pozitive dhe menaxhimin e klasës;
- Menaxhimi i mjedisit fizik dhe shoqëror të klasës për të mbështetur të nxëniet;
- Mënyrat e evidentimit dhe më pas adresimi i pengesave të ndryshme që lidhen me të nxëniet dhe implikimet e tyre me mësimdhënien;
- Zhvillimi i aftësive profesionale bazë, në veçanti i kompetencave kryesore, bashkë me metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit;
- Vlerësimi i metodave të mësimdhënies dhe të nxëniet duke u përqëndruar tek evidentimi i pikave të forta të një nxënësi;

- Diferencimin e përmbajtjes kurrikulare, procesit të të nxënit dhe materialeve didaktike, me qëllim përfshijes e nxënësve dhe përmbushjen e nevojave të ndryshme;
- Metodologji të personalizuar të të nxënit për të gjithë nxënësit që mbështesin dhe nxisin autonominë e të nxënit të tyre;
- Hartimi, zbatimi dhe shqyrtimi efikas i Planeve Edukative Individuale (PEI) apo programe të tjera të ngjashme të individualizuara, sipas rastit.
- Përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve ndihmëse në mbështetje të procesit të të nxënit;
- Planifikimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies në bazë të nevojave, interesave dhe mënyrave sesi vet nxënësi e percepton mjedisin. Kombinimi i detyrave dhe kërkesave ndaj nxënësve me aftësitë dhe mundësitë e tyre;
- Identifikimi i pikave të forta të nxënësit e më pas kombinimi i tyre me dobësitë;

Aftësitë themelore që kërkohet të zhvillohen në këtë kompetence përfshijnë:

- Përdorimi i aftësive drejtuese ku përfshihen metodika sistematike për manaxhimin pozitiv të klasës;
- Puna me individë dhe me grupe diverse Përdorimi i kurrikulës si instrument për përfshirjen që nxit aksesin ndaj të nxënit;
- Trajtimi i tematikave të diversitetit në proceset e hartimit të kurrikulave;
- Diferencimi i metodave, përmbajtjes dhe rezultateve për të nxënit;
- Puna me nxënësit dhe familjet e tyre, për ta bërë të mësuarin një proces të individualizuar, me objektiva të vendosura në partneritet me prindërit ;
- Nxitja e të nxënit në bashkëpunim, ku nxënësit ndihmojnë njëri tjetrin në mënyra të ndryshme brenda grupimeve fleksibël të nxënësve;
- Përdorimi në mënyrë sistematike i një game metodash dhe taktikash didaktike;
- Përdorimi i teknologjisë së komunikacionit në mbështetje të teknikave fleksibël të të nxënit;
- Përdorimi i metodave të mësimdhënies të bazuara mbi fakte, për të arritur synimet e të nxënit, rrugët alternative të të nxënit dhe mësimdhënien fleksible;
- Përdorimi i vlerësimit formues dhe përmbledhës që mbështet të nxënit dhe nuk etiketon apo con në pasoja negative për nxënësit;

- Angazhim në bashkëpunimin për zgjidhjen e problemeve me nxënësit;
- Vendosja në një sërë formash verbale dhe jo-verbale të komunikimit, për nxitur të nxënin.
- Planifikimi në bashkëpunim me mësuesë të tjerë

3. Bashkëpunimi me të tjerët – bashkëpunimi dhe puna në ekip janë elementë thelbësorë në punën e të gjithë mësuesve.

Kompetencat e nevojshme për këtë vlerë themelore janë:

- 3.1 Bashkëpunimi me prindërit dhe familjet;
- 3.2 Bashkëpunimi me një sërë profesionistësh të tjerë të fushës së arsimit.

3.1 Puna me prindërit dhe familjet

Qëndrimet dhe bindjet që lidhen me këtë kompetence përfshijnë:

- Ndërgjegjësimin në lidhje me vlerat e shtuara të bashkëpunimit me prindërit dhe familjet;
- Respektin për sfondin kulturor, prejardhjen shoqërore dhe perspektivat e prindërve dhe familjeve;
- Perceptimi i komunikimit dhe bashkëpunimit efikas me prindërit dhe familjet si përgjegjësi e mësuesit.

Njohuritë themelore që lidhen me këtë kompetence përfshijnë:

- Mësimdhënie gjithëpërfshirëse bazuar mbi një qasje bashkëpunimi;
- Rëndësia e aftësive pozitive ndërpersonale;
- Ndikimi i marrëdhënieve ndërpersonale në arritjen e objektivave të të nxënit.

Aftësitë themelore që kërkohet të zhvillohen në këtëkompetence përfshijnë:

- Përfshirje aktive e prindërve dhe familjeve për të mbështetur procesin e të nxënësve të tyre;
- Komunikim efikas me prindërit dhe familjarët me prejardhje të ndryshme kulturore, etnike, gjuhësore dhe shoqërore.
- Prindi si partner në edukim, që nënkupton përfshirjen aktive dhe me kompetenca konkrete duke caktuar rolet që mund të ndikojnë dhe të japin një kontribut konkret në procesin mësimor.

3.2 Bashkëpunimi me një sërë profesionistësh të tjerë të fushës së arsimit

Qëndrimet dhe bindjet që lidhen me këtëkompetence përfshijnë:

- Arsimit gjithëpërfshirës kërkon nga të gjithë mësuesit të punojnë në ekip;
- Bashkëpunimi, partneriteti dhe puna në skuadër janë metoda të rëndësishme për të gjithë mësuesit dhe duhen përkrahur;
- Arsimit gjithëpërfshirës kërkon shfrytëzimin e të gjithë burimeve në komunitet;
- Bashkëpunimi me shkolla të tjera, institucione, agjenci, qendra komunitare etj;
- Puna në bashkëpunim mbështet zhvillimin profesional me dhe nga profesionistët e tjerë.

Njohuritë themelore që lidhen me këtëkompetence përfshijnë:

- Vlera dhe përfitimet nga bashkëpunimi me mësues dhe profesionistë të edukimit e më gjerë;
- Disponibiliteti i sistemeve dhe strukturave mbështetëse për më shumë ndihmë, kontribut dhe këshillim;
- Modele të punës me shumë institucione ku mësuesit në klasa gjithëpërfshirëse bashkëpunojnë me specialistë të tjerë nga një sërë disiplinash të ndryshme;
- Mësimdhënie bashkëpunuese ku mësuesit përdorin metodat që përfshijnë vetë nxënësit, prindërit, kolegët, mësues të shkollave të tjera, personelin mbështetës, si edhe anëtarë të ekipeve multi-disiplinore, sipas rastit;

- Përqasja e gjuhës, terminologjisë dhe koncepteve të perspektivave bazë të punës së profesionistëve të tjerë të fushës së edukimit;
- Fuqia e marrëdhënieve që vendosen midis aktorëve të ndryshëm të interesit, të cilët duhen njohur dhe duhen trajtuar me efikasitet.

Aftësitë themelore që kërkohet të zhvillohen në këtë kompetence përfshijnë:

- Zbatimi i aftësive të udhëheqjes dhe menaxhimit të klasës që ndihmojnë në lehtësimin e ndërveprimit dhe bashkëpunimit midis institucioneve të ndryshme;
- Bashkësimdhënia dhe puna në ekipe fleksibël mësimeje;
- Të punuarit si pjesë e një komuniteti shkollor dhe mbështetja tek burimet e brendshme dhe të jashtme të shkollës;
- Krijimi i një komuniteti brenda klasës si pjesë e komunitetit të gjerë të shkollës;
- Kontributi në vlerësimin në nivel shkolle, rishikimin dhe proceset zhvilluese;
- Zgjidhja e problemeve në bashkëpunim me profesionistë të tjerë;
- Nxitja e krijimit të partneriteteve më të gjera shkollore, me shkolla të tjera dhe organizata komunitare, si edhe me organizata të fushës së arsimit;
- Mbështetja tek një sërë aftësish profesionale verbale dhe jo-verbale, për të nxitur bashkëpunimin me profesionistë të tjerë.

4 Vazhdimësia e zhvillimit profesional individual – mësimeje është një veprimtari që ka të bëjë me të nxënin dhe mësuesit marrin përgjegjësi për të mësuarin e tyre gjatë gjithë jetës.

Kompetencat e nevojshme për këtë vlerë themelore janë:

4.2 Mësuesit si profesionistë që reflektojnë;

4.3 Formimi i mësuesve si themel për zhvillimin e vazhdueshëm profesional.

7.1 Mësuesit si profesionistë që reflektojnë

Qëndrimet dhe bindjet që lidhen me këtë kompetence përfshijnë:

- Mësimdhënia është një aktivitet që kërkon një planifikim, vlerësim dhe reflektim sistematik të vazhdueshëm që më pas kërkon përshtatje;
- Praktikrat reflektuese i vijnë në ndihmë mësuesve për një bashkëpunim efikas me prindërit si edhe në ekipe me mësues dhe profesionistë të tjerë brenda shkollës dhe jashtë saj;
- Rëndësia e praktikës së bazuar tek faktet, si udhëzues për punën e mësuesit;
- Vlerësimi i rëndësisë së krijimit të një pedagogjie personale/individuale që drejton punën e mësuesit.

Njohuritë themelore që lidhen me këtë kompetence përfshijnë:

- Aftësitë individuale për të transmetuar njohuritë, për të shfaqur qëndrimet Elementët që duhet të ketë një punonjës që reflekton dhe si zhvillohet reflektimi individual në punë e sipër;
- Metodrat dhe strategjitë për vlerësimin e punës dhe performancës së vetë individit;
- Metodrat e hulumtimit dhe përdorimi i tyre në punën e mësuesit;
- Ndërtimi i strategjive personale për zgjidhjen e problemeve.

Aftësitë themelore që kërkohet të zhvillohen në këtëkompetence përfshijnë:

- Vlerësimi sistematik i performancës individuale;
- Përfshirja me efikasitet e të tjerëve në reflektimin e mësimdhënies dhe të nxënit;
- Kontributi për zhvillimin e shkollës, si komunitet ku mësohet.

4.2 Formimi i mësuesve si themel për zhvillimin e vazhdueshëm profesional

Qëndrimet dhe bindjet që lidhen me këtë kompetence përfshijnë:

- Mësuesit kanë përgjegjësi për zhvillimin dhe rritjen e tyre të vazhdueshme profesionale;
- Arsimiti fillestar i mësuesit përfaqëson hapin e parë të një jete profesionale të profesionit të mësuesisë;
- Mësimdhënia është një aktivitet ku mësohet; kur dikush është i hapur për të zhvilluar kapacitete të reja profesionale dhe kërkon vazhdimisht informacion dhe kërkon të këshillohet kjo padyshim është një gjë pozitive;
- Mësuesi nuk mund të jetë ekspert për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me arsimin gjithëpërfshirës. Dijet bazë për ata që fillojnë në arsimin gjithëpërfshirës janë shumë të rëndësishme, por esenca është të mësoarit gjatë gjithë jetës;
- Ndryshimi dhe zhvillimi është i vazhdueshëm në arsimin gjithëpërfshirës, ndaj edhe mësuesve u duhen aftësitë profesionale për të manaxhuar dhe për t'iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave në ndryshim gjatë gjithë karrierës së tyre.

Njohuritë themelore që lidhen me këtë kompetence përfshijnë:

- Ligji për arsimin parauniversitar dhe Dispozitat Normative si edhe përgjegjësitë dhe detyrimet e mësuesve përkundrejt nxënësve, familjeve të tyre, kolegëve dhe profesionit të mësuesisë brenda atij konteksti juridik;
- Mundësitë dhe rrugët për formimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të mësuesve, me qëllim zhvillimin e dijeve dhe kapaciteteve profesionale, për të cuar më tej punën e tyre gjithëpërfshirëse.

Aftësitë themelore që kërkohet të zhvillohen në këtëkompetence përfshijnë:

- Fleksibiliteti në zgjedhjen e strategjive mësimdhënëse që nxisin novatorizimin dhe dijet personale;
- Zbatimi i strategjive për manaxhimin e kohës që krijojnë mundësi për zhvillimin e karrierës në vendin e punës;
- Të qenit i hapur dhe aktiv, për t'i përdorur kolegët dhe profesionistët e tjerë si burim për të mësuar dhe si burim frymëzimi;
- Kontribuimi në gjithë proceset e zhvillimit dhe të nxënimit të komunitetit të shkollës.

Zbatimi i profilit të mësuesit gjithëpërfshirës

Parime të përgjithshme

Deklaratat e mëposhtme janë një përmbledhje e parimeve të përgjithshme për të cilat ka dakordësi se qëndrojnë në themel të vlerave themelore dhe të kompetencave të propozuara brenda kuadrit të Profilit të Mësuesit Gjithëpërfshirës.

1. Vlerat dhe fushat e kompetencave për të punuar, si pjesë e arsimit gjithëpërfshirës, janë të nevojshme për të gjithë mësuesit, sikundër se arsimi gjithëpërfshirës është përgjegjësi e të gjithë mësuesve.
2. Vlerat dhe kompetencat për arsimin gjithëpërfshirës u sigurojnë mësuesve themelet për punën me nxënës me një sërë nevojash të ndryshme brenda një klase në shkollat e arsimit parauniversitar. Ky është një dallim i rëndësishëm që e kalon vëmendjen e përfshirjes përtej plotësimit të nevojave të grupeve të veçanta të nxënësve (si p.sh. nxënës me nevoja të veçanta). Vlerat dhe fushat e kompetencave theksojnë më tej mesazhin e rëndësishëm sipas të cilit arsimi gjithëpërfshirës është një qasje për të gjithë nxënësit, dhe jo thjesht e vetëm për grupe të posaçme, me nevoja të posaçme.
3. Vlerat dhe kompetencat e evidentuara në këtë dokument janë themeli i qëndrimeve, njohurive dhe aftësive profesionale bazë që nevojiten gjatë formimit dhe zhvillimit të karrierës së mësuesit. Kompetencat janë pjesë integrale e zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Këto kompetenca duhet të zhvillohen vazhdimisht gjatë karrierës profesionale të çdo mësuesi.
4. Vlerat dhe kompetencat që u duhen të gjithë mësuesve për të punuar në institucione arsimore gjithëpërfshirëse nuk bien ndesh me formimin dhe trajnimin e specializuar për mësuesit e arsimit special. Këto vlera dhe kompetenca janë baza e punës së të gjithë mësuesve, qoftë në arsimin e përgjithshëm, qoftë në atë special.
5. Vlerat dhe kompetencat e përshkruara në këtë dokument janë lënë enkas të gjera, për të mbështetur zhvillimin profesional të mësuesve si profesionistë që nxënë gjatë gjithë jetës edhe reflektojnë përmes të nxënësve eksperimental dhe hulumtimeve.
6. Vlerat dhe kompetencat mund të mbështesin zhvillimin profesional të studentëve mësues dhe mund të jenë një burim për të nxitur punën e pedagogëve në fakultetet që përgatisin mësuesit e ardhshëm.

7. Vlerat dhe kompetencat për mësuesin gjithëpërfshirës duhen parë si pikënisje për hartimin dhe planifikimin e programeve për zhvillimin profesional të mësuesve. Parimi i arsimit gjithëpërfshirës si një qasje sistemike, duhet të zbatohet si për trajnimin e mësuesve ashtu edhe për kurikulën shkollore.
8. Integrimi i vlerave dhe kompetencave për edukimin gjithëpërfshirës në procesin e formimit dhe zhvillimit profesional të mësuesve, duhet diskutuar me një numër të gjerë aktorësh interesi në rrethana dhe kontekste të ndryshme kombëtare. Përmes një dialogu të tillë, kompetencat mund të jenë një mekanizëm me vlerë për reduktimin e shkëputjes që perceptohet se ekziston midis mësuesve nëpër shkolla dhe aktorëve të tjerë të interesit në fushën e arsimit.

Zbatimi i profilit

Një element i rëndësishëm që ka dalë qartë gjatë punës për hartimin e Profilit ka të bëjë me faktin se synimi i formimit dhe zhvillimit profesional të mësuesve duhet parë si:

- Zhvillim i aftësive të kuadrit mësimdhënës, të ri dhe në shërbim, për të qenë më gjithëpërfshirës në praktikën e tyre të punës;
- Përgatitje dhe zhvillim profesional i mësuesve për të qenë efikas në mësimdhënie, si edhe ekspertë në lëndët që japin.

Profili i Mësuesit Gjithëpërfshirës është përpiluar në mënyrë të tillë që të mbështesë këtë synim për të gjitha programet e zhvillimit profesional të mësuesve. Vlerat themelore dhe kompetencat janë transversale – ato nuk i përkasin një sektori apo lënde të vetme. Po kështu, vlerat themelore dhe kompetencat nuk kanë epërsi mbi një metodë të caktuar.

Profili i Mësuesit Gjithëpërfshirës është hartuar kryesisht si një udhëzues për hartimin dhe zbatimin e programeve të formimit dhe zhvillimit profesional për të gjithë mësuesit. Ai nuk duhet marrë si i mirëqenë, por duhet konsideruar më shumë si material nxitës për evidentimin e përmbajtjes së duhur, metodave të duhura dhe rezultateve të dëshiruara.

Procesi i hartimit të profilit

Përgatitja e dokumentit të profilit të mësuesit gjithëpërfshirës është realizuar përmes një procesi kompleks, mbështetur: në rekomandime të dokumenteve politikë dhe strategjikë globalë e kombëtarë mbi arsimin gjithëpërfshirës, në shqyrtimin e prirjeve evropiane dhe më gjerë, në modele të standardeve për arsimin gjithëpërfshirës, si dhe në analizën e kurrikulës aktuale të arsimit parauniversitar.

Draft-dokumenti iu nënshtrua një procesi diskutimesh e refleksionesh me pedagog të fakulteteve: Fakulteti i Edukimit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti i Shkencave të Edukimit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore Gjirokastrë dhe Fakulteti i Shkencave Sociale Tiranë. Pedagogët që kanë marr pjesën në diskutimin e këtij dokumenti kanë qenë të profileve të ndryshme si të metodikës, psikologjisë zhvillimore, edukimit qytetar, edukimit muzikor, teknologjisë së informacionit në edukim, etj. Në takim kanë marr pjesë edhe dekan, zëvendës dekan, dhe drejtues departamentesh të disa prej universiteteve.

Pjesë e konsultimeve kanë qenë edhe përfaqësues të DAR-ve të katër qyteteve: Tiranë, Durrës, Gjirokastrë dhe Shkodër. Në këto takime kanë marr pjesë specialistë të DAR-ve që merreshin me AK, shërbimin psiko-social. Kanë marr pjesë drejtues shkollash të zonave rurale dhe urbane, mësues të shkollave 9-vjecare (fshat/qytet), mësues me dhe pa eksperiencë në fushën e arsimit gjithëpërfshirës.

Pjesëmarrësit janë njohur me dokumentin “Profili i mësuesit gjithëpërfshirës”, qëllimin e dokumentit dhe vlerat themelore të këtij dokumenti. Më pas ata kanë diskutuar rreth rëndësisë që ka në përgatitjen e mësuesve me kompetencat bazë të arsimit gjithëpërfshirës, si dhe kanë dhënë sugjerimet dhe rekomandimet e tyre të para si në planin e ndërtimit të kurrikulave gjithëpërfshirëse por edhe në nivel sesa aplikohet arsimit gjithëpërfshirës.

.....

Referencat

1. Ligji për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, Nr.69/2012, i amenduar Ligji Nr.56/2015
2. Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 (MAS)
3. MAS (2014), Korniza Kurrikulare e Shqipërisë, Tiranë.
4. Organizata Botërore e Shëndetësisë (2011) Raport botëror mbi aftësinë e kufizuar. OBSH
5. Remacka. L. Kulla. F. Ndrio, M, (2014) Manuali: Jam mes jush, i ngjashëm, i ndryshëm, i barabartë. orld Vision dhe MEDPAK
6. Booth, T. (2010) Teacher Education for inclusion: Hoë can ëe kno it is of high quality? Fjalim i mbajtur në konferencën e projektit për edukimin e mësuesve për të qenë gjithëpërfshirës; Zyrih, shtator 2010. I disponueshëm me kërkesë tek Sekretariati iAgjencisë secretariat@european-agency.org
7. Delors, J. et al. (1996) Learning, the treasure ëithin. Raporti në UNESCO iKomisionit Ndërkombëtar për Arsimin në shekullin 21, Paris, Francë: UNESCO
8. Denzin, N. K. (1979) The research act: A theoretical introduction to sociological methods. Nju Jork: McGra-Hill
9. Agjencia Europiane për Zhvillimin e Arsimit të Nevojave të Posacme (2011) “Arsimimi i mësuesve për garantimin e gjithëpërfshirjes në Evropë– Sfida dhe mundësi. Odense, Danimarkë:Agjencia Europiane për Zhvillimin e Arsimit të Nevojave të Posacme
10. Komisioni Evropian(2009) kuadri strategjik për arsim dhe trainim. Bruksel: Komisioni Evropian. Varianti elektronik: http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-policy/doc28_en.htm
11. Komisioni Evropian, DG-Arsimi dhe Kultura(2010): Përmirësimi iCilësisë së Mësuesve: Axhenda e BE-së. Dokument i përgatitur nga Holdsorth, P., ku jepet një përmbledhje e prioriteteve për përmirësimin e arsimimit të mësuesve, sipas përkufizimit të Ministrave të Arsimit, në Konkluzionet e Këshillit, nëntor 2007, 2008 dhe 2009
12. Komisioni Evropian, DG – Arsimi dhe Kultura (2011) Grupi tematik ipunës “zhvillimi profesional i mësuesve”: Raporti iaktivitetit : Politikat për përkufizimin dhe përshkrimin e kompetencave të mësuesve

13. Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) (2009):
Udhëzime politikash për përfshirjen në arsim, Paris: UNESCO
14. UNICEF dhe UNESCO (2007) “A Human Rights-Based Approach to Education for All: A framework for the realization of children’s right to education and rights within education”.
UNICEF, Nju Jork dhe UNESCO, Paris